



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 130, 131 dhe 132 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose panelit për lirim me kusht.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-102.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në BZHKE.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për organizimin dhe operimin e sistemit të monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe procedurat e përcaktimit të shkallës së invaliditetit për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Forcës së Sigurisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Mitrovicës për përkrahje financiare në vlerë 70,000.00 euro për pagesën e qirasë së 133 familjeve që jetojnë në pjesën veriore, të rasteve sociale dhe familjeve të kategorive të luftës për periudhën nga 1 janar deri 31 dhjetor 2013.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në buxhetin e Komunës së Mitrovicës, në programin Shërbimet Publike, kategoria subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi pas rishikimit të Buxhetit për vitin 2013.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Ndërmintor për luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë, me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhduar të zbatimit të planit të Strategjisë së Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë në këtë përbërje:
 - 1.1. Ferid Agani, Ministria e Shëndetësisë, anëtar;
 - 1.2. Isuf Dedushaj, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3. Salih Ahmeti, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Bajram Imeri, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.5. Shaban Galloperi, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 1.6. Sami Sinani, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
 - 1.7. Ismet Ibishi, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.8. Nazmije Fazliu, Ministria e Financave, anëtar;
 - 1.9. Avni Sahiti, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.10. Xhevdet Tahiraj, Ministria e Forcës së Sigurisë, anëtar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-221, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit për vitin 2013.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë mjete financiare në shumë prej 218,000.00 euro sipas vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të marrur më 25 korrik 2013 dhe atë:
 - 1.1. 118,000.00 euro për projektin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Kmetovc", Komuna e Gjilanit, kategoria ekonomike, shpenzimet kapitale dhe
 - 1.2. 100,000.00 euro për projektin "Ndërtimi i kanalizimit në Rezallë-Skenderaj" në MMPH, nën-programin Burimet ujore me kod 210603, kategoria ekonomike, shpenzime.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimin ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara, kategoria ekonomike kapitale.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/141

Datë: 26.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2013, mori:

V E N D I M

Për organizimin dhe funksionimin e strukturave për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë së Reformës në Administratën Publike

Neni 1
Qëllimi

Me këtë vendim përcaktohet funksionimi institucional i strukturave përgjegjëse për të siguruar, koordinuar dhe monitoruar zbatimin e Strategjisë së Rishikuar të Reformës së Administratës Publike dhe Planit të Veprimit (SRAP/PVRAP) si dhe strukturave përgjegjëse për zbatimin e SRAP/PVRAP.

Neni 2
Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të SRAP/PVRAP

1. Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të SRAP/PVRAP është Komisioni Ndërminstoror për Reformën e Administratës Publike (KNRAP), i cili ka këtë përbërje:

- 1.1. Ministri i Ministrisë së Administratës Publike (kryesues);
- 1.2. Ministri i Ministrisë së Drejtësisë (anëtar);
- 1.3. Ministri i Ministrisë së Financave (anëtar);
- 1.4. Ministri i Ministrisë së Integrimeve Evropiane (anëtar);
- 1.5. Ministri i Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal (anëtar);
- 1.6. Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (anëtar);
- 1.7. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit (anëtar).

2. Për të siguruar zbatimin e SRAP/PVRAP, KNRAP ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

- 2.1. Drejton dhe mbikëqyrë në nivel politik të gjitha çështjet që ndërlidhen me procesin e zbatimit të SRAP/PVRAP;
 - 2.2. Shqyrton raportet tre-mujore të progresit mbi zbatimin e SRAP/PVRAP;
 - 2.3. Zgjidhë çështjet që pengojnë dhe/apo vështirësojnë progresin e zbatimit të SRAP/PVRAP, në pajtim me politikat qeveritare;
 - 2.4. Propozon në Qeveri për plotësim-ndryshimin e SRAP/PVRAP dhe
 - 2.5. Vendosë për adresimin e çështjeve në Qeveri që ndërlidhen me zbatimin e SRAP/PVRAP.
3. Takimet e KNRAP për zbatimin e SRAP/PVRAP ftohen nga Kryesuesi dhe mbahen kur gjykohet që ka çështje për t'u shqyrtuar, por jo më pak se një (1) herë në tre (3) muaj. Për mbajtjen e takimit të KNRAP të pranishëm duhet të jenë së paku pesë (5) nga shtatë (7) anëtarët.
4. Kryesuesi i KNRAP mund të ftojë në takime edhe Ministra apo përfaqësues të institucioneve dhe/apo organizatave tjera, nëse çështjet që pritet të shqyrtohen lidhur me zbatimin e SRAP/PVRAP ndërlidhen me fushëveprimtaritë e institucioneve që ata përfaqësojnë.
5. Në takimet e KNRAP merr pjesë edhe Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike në cilësi të vëzhguesit dhe i cili mund të debatoj për çështjet që ngritën për zbatimin e SRAP/PVRAP por pa të drejtë vote.
6. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, propozimet e KNRAP miratohen me shumicë votash dhe secili vendim specifikon zgjidhjen e arritur për çështjen e shqyrtuar dhe veprimet e mëturshme që duhen ndërmarrë nga ministria apo institucioni përkatës për zbatimin e vendimit në kohën e caktuar.
7. Propozimet procedohen në Qeveri për aprovim.

Neni 3

Struktura përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të SRAP/PVRAP

1. Struktura përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të SRAP/PVRAP është Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike (DMRAP) në Ministrinë e Administratës Publike.
2. Për të koordinuar dhe monitoruar zbatimin e SRAP/PVRAP dhe në pajtim me dispozitat e këtij vendimi, DMRAP ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:
 - 2.1 Ofron informata cilësore, të sakta dhe të vazhdueshme mbi zbatimin e SRAP/PVRAP për Kryesuesin e KNRAP;
 - 2.2 Përgatit raportin përmbledhës tremujor mbi bazën e raporteve përkatëse të koordinatorëve për zbatimin e SRAP/PVRAP që dërgohen në DMRAP çdo tre (3) muaj, përmes Sekretarëve të Përgjithshëm të ministrive përkatëse dhe për fushën e prokurimit publik nga udhëheqësi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të bashkërenduar me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave;

2.3 Në fund të çdo viti kalendarik, përgatit raportin përmbledhës vjetor dhe vlerëson realizueshmërinë e aktiviteteve të përcaktuara në SRAP/PVRAP dhe propozon drejtimet e përditësimit të tij;

2.4 Mbi bazën e problematikës së nxjerrë nga raportet përmbledhëse, kërkesave të institucioneve dhe/apo çështjeve të tjera që përmirësojnë ecurinë e procesit të zbatimit të SRAP/PVRAP, propozon projekt-agjendën e takimeve të KNRAP dhe e përcjell për shqyrtim dhe miratim tek Kryesuesi i KNRAP;

2.5 Formulon konkluzionet dhe vendimet e mbledhjes së KNRAP të cilat, pas miratimit nga Kryesuesi, i përcjell brenda një (1) jave për informacion dhe veprime të mëtutjeshme tek institucionet e përfshira në problematikën e agjendës së takimeve dhe

2.6 Ushtron veprimtari të ndërsjellë informuese, monitoruese, koordinuese dhe ndihmuese pranë të gjitha strukturave përgjegjëse për zbatimin e SRAP/PVRAP.

Neni 4

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e SRAP/PVRAP

1. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të PVRAP janë institucionet vijuese:

- 1.1. Zyra e Kryeministrit (ZKM);
- 1.2. Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe
- 1.3. Ministria e Financave (MF).

2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive përkatëse obligohen për zbatimin e aktiviteteve të PVRAP.

3. Përgjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në objektivin e tetë (8) të PVRAP është Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, që bashkërendon aktivitetet e kësaj objekte me MF.

4. Në pajtim me paragrafin 1. dhe 3. të këtij neni dhe për sigurimin e shpejtë dhe efektivisht zbatimin e aktiviteteve të PVRAP, për çdo objektiv të PVRAP caktohet nga një (1) koordinator si vijon:

- 4.1. Udhëheqësi i Zyrës për Planifikim Strategjik pranë ZKM, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e parë (1) mbi Planifikimin Strategjik;
- 4.2. Udhëheqësi i Zyrës Ligjore pranë ZKM, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e dytë (2) mbi Hartimin e Legjislacionit;
- 4.3. Udhëheqësi i Zyrës për Qeverisje të Mirë pranë ZKM, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e tretë (3) mbi Etikën dhe Transparencën;
- 4.4. Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim pranë ZKM, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e katërt (4) mbi Komunikimin me Qytetarë;
- 4.5. Udhëheqësi i Departamentit të Buxhetit pranë MF, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e pestë (5) mbi Planifikimin e Buxhetit;
- 4.6. Udhëheqësi i Departamentit të Thesarit pranë MF, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e gjashtë (6) mbi Ekzekutimin e Buxhetit;
- 4.7. Udhëheqësi i Njësisë Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm pranë MF, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e shtatë (7) mbi Kontrollin dhe Auditimin e Brendshëm;
- 4.8. Udhëheqësi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e tetë (8) mbi Prokurimin Publik;

4.9. Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike pranë MAP, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e nëntë (9) mbi Organizimin e Administratës Publike;

4.10. Udhëheqësi i Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil pranë MAP, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e dhjetë (10) mbi Menaxhimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore;

4.11. Udhëheqësi i Divizionit për Procese Administrative pranë MAP, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e njëmbëdhjetë (11) mbi Racionalizimin e Proceseve Elektronike Administrative (e-qeverisja) dhe

4.12. Udhëheqësi i Departamentit për e-Qeverisje dhe Procese Administrative pranë MAP, koordinon zbatimin e aktiviteteve për objektiven e dymbëdhjetë (12) mbi Qeverinë Elektronike (e-qeveria).

5. Koordinatorët e përcaktuar me paragrafin 4. të këtij neni, veprojnë në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe sigurohen që zbatimi i aktiviteteve të realizohet me cilësi të lartë dhe në afatin e përcaktuar kohor në PVRAP.

Neni 5

Grupi punues i PVRAP

1. Për koordinimin efektiv të procesit të zbatimit të aktiviteteve të PVRAP, krijohet Grupi Punues (GP) i PVRAP në përbërje të Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM, MF, MAP, të koordinatorëve të përcaktuar me nenin 4, paragrafin 4, të këtij vendimi si dhe të një (1) përfaqësuesi të Ministrisë përgjegjëse për integrim evropian dhe të një (1) përfaqësuesi të Ministrisë përgjegjëse për administrim të pushtetit lokal.

2. GP i përcaktuar me paragrafin 1. të këtij neni, që udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM, mbledhet çdo tre (3) muaj dhe organizohet nga DMRAP.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit Punues janë:

3.1. Sigurimi i zbatimit të vendimeve të KNRAP me cilësi të lartë dhe me shpejtësi;

3.2. Shqyrtimi i performancës dhe koordinimi i veprimeve për zbatimin e plotë dhe efektiv të aktiviteteve të PVRAP;

3.3. Identifikimi dhe propozimi i masave procedurale/teknike që duhet ndërmarrë për zbatimin e plotë dhe efektiv të aktiviteteve të PVRAP;

3.4. Evidentimi i sfidave dhe ngecjeve eventuale gjatë procesit të zbatimit të PVRAP dhe propozimi i zgjidhjeve për tejkalimin e tyre;

3.5. Përcaktimi i prioritetëve për zbatimin e aktiviteteve të PVRAP, sipas nevojës dhe

3.6. Diskutimi i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e aktiviteteve të caktuara.

4. Në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni dhe pas çdo takimi të GP-së, Kryesuesi i KNRAP informohet nga DMRAP për konkluzionet dhe rekomandimet që dalin nga takimi.

5. Kryesuesi i GP raporton në takimet e KNRAP mbi progresin dhe sfidat që evidentohen në takimet e Grupit.

Neni 6

Nëngrupet punuese

1. Për zbatimin efektiv të SRAP/PVRAP, krijohen dymbëdhjetë (12) Nëngrupe Punuese (NGP), përshtatshmërisht objektive të SRAP/PVRAP, që kryesohen nga koordinatorët e përcaktuar me nenin 4 paragrafi 4 të këtij vendimi, dhe titullohen si vijon:

- 1.1. Nëngrupi Punues për Menaxhim të Politikave;
- 1.2. Nëngrupi Punues për Hartimin e Legjislacionit;
- 1.3. Nëngrupi Punues për Etikën dhe Transparencën;
- 1.4. Nëngrupi Punues për Komunikimin me Qytetarë;
- 1.5. Nëngrupi Punues për Planifikimin e Buxhetit;
- 1.6. Nëngrupi Punues për Ekzekutimin e Buxhetit;
- 1.7. Nëngrupi Punues për Kontrollin dhe Auditimin e Brendshëm;
- 1.8. Nëngrupi Punues për Prokurimin Publik;
- 1.9. Nëngrupi Punues për Organizimin e Administratës Publike;
- 1.10. Nëngrupi Punues për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore;
- 1.11. Nëngrupi Punues për Racionalizimin e Procesteve Elektronike Administrative (e-Qeverisja);
- 1.12. Nëngrupi Punues për Qeverinë Elektronike (e-Qeveria);

2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, NGP-të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre konform fushave përkatëse për informim dhe koordinim të mirëfilltë në zbatimin e veprimeve të PVRAP.

2. Takimet e NGP-ve, që organizohen dhe ftohen nga koordinatorët, zhvillohen çdo tre (3) muaj dhe dy (2) javë para mbajtjes së takimit të Grupit Punues.

3. Në pajtim me dispozitat e këtij vendimi dhe bazuar në fushëveprimtaritë e NGP-ve, përpos DMRAP, në takime ftohen gjithashtu të marrin pjesë nga çdo ministri dhe Zyra e Kryeministrit nga një (1) përfaqësues, identifikimi i të cilëve bëhet në bazë të fushave që ndërlidhen me zbatimin e aktiviteteve të objektivës, si dhe sipas nevojës, ekspertë të fushave të caktuara.

Neni 7

Shfuqizohet vendimi i Qeverisë Nr. 05/82, i datës 4 korrik 2012.

Neni 8

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë